



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr. 172 / prot
29

Tiranë, më 04 / 1 / 2022

Lënda: Procedurat, vlerësimi i aplikimit për licensë të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, dhe formati shpjegues për aplikimet online.

- PROCEDURAT, VLERËSIMI I APLIKIMIT PËR LICENSË TË VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMIT JONIZUES, DHE FORMATI SHPJEGUES PËR APLIKIMET ONLINE.

Aplikimi për licensë bëhet për të gjitha veprimtaritë që i parashikon ligji “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ” Nr. 8025 datë 9/11/1995 i ndryshuar. Aplikimi për licensë realizohet elektronikisht në platformën e-albania në përputhje me ligjin Nr .10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik” i ndryshuar, ligjin Nr.9880, datë 25.2.2008, “Për Nënshkrimin Elektronik”, i ndryshuar, VKM Nr.252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim ofruese dhe metodologjinë e monitorimit dhe kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.

Personi përgjegjës në ZMR njoftohet për aplikimin nëpërmjet platformës elektronike e-Albania. Pasi bën vlerësimin brenda afateve njofton përdoruesin në lidhje me procedurat e mëtejshme nëpërmjet platformes online.

Pas marrjes së aplikimit Kryetari ZMR vendos për procedurë të mëtejshme jo më vonë se 24 orë nga momenti i aplikimit.

-Personi përgjegjës i ZMR-së bën një vlerësim të përgjithshëm të aplikimit duke parë plotësimin e të gjithë kriterëve. Nqs për arsye të ndryshme personi përgjegjës nuk gjendet në ZMR, paraprakisht kjo detyrë i ngarkohet në mënyrë të përkohëshme një prej inspektorëve të ZMR me miratim të kryetarit. Për plotësimin e raportit vlerësues mund të kërkohen dokumente shtesë kur është e nevojshme ose bëhet verifikimi në vend nëpërmjet një inspektimi në ambjentet ku do të kryhet veprimtaria . Ky vlerësim bazohet në aktivitetin e burimit dhe praktikën duke marrë në konsideratë riskun që vjen nga kjo veprimtari.

Raporti vlerësues duhet të jetë i plotë dhe duhet të përfshijë të gjithë elementët sipas Modelit për Vlerësim(bashkëngjitur këtij materiali) dhe të sigurojë që e gjithë veprimtaria është në përputhje me rregulloret e miratuara dhe të gjithë elementët e aplikimit për licensë janë plotësuar. Raport vlerësues për burimet e kategorisë 1 dhe 2 përgatitet brenda 4 javësh nga momenti i marrjes së aplikimit online. Për burimet e kategorisë 3,4,5, dhe gjeneratorët me rreze X brenda 2 javësh nga momenti i marrjes së aplikimit online. Raporti vlerësues mban datën e përpilimit dhe nënshkrimin elektronik të inspektorit.

Ky raport i paraqitet Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për dhënien e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin për licensë. Mbas miratimit nga KMR raporti i mbledhjes dhe dosja përfundimtare nënshkruhet dhe vulozet nga sekretari i KMR dhe Kryetari i KMR.

Në zbatim të nenit 6 pika 3 (a), nenit 7 pika 3(a) dhe nenit 8 pika 4 (c) të rregullores Nr. 877 datë 30.10.2015 "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", të gjithë subjektet që do të aplikojnë për veprimtari me burime radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3 duhet të dërgojnë në ZMR para fillimit të plotësimit të procedurave online për licencë/amendim/rinovim, listën e punonjësve që do të kenë akses/informacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërinë të tyre.

Veprimtaria për miratimin nga ana e KMR do mbetet jashtë sistemit e-albania

E gjithë veprimtaria e ZMR do jetë në përputhje me sistemin e-albania. Në rastet kur nuk ka sistem online, aplikimi për licensë bëhet pranë ZMR tek personi i ngarkuar për këtë qëllim.

E gjithë veprimtaria e mësipërme në ZMR duhet të jetë pjesë e punës në grup, si element shumë i rëndësishëm në realizimin me sukses të detyrave.

Bashkëngjitur procedurës gjenden formatet e aplikimit dhe sqarimet përkatëse

MODEL I VLERËSIMIT TË APLIKIMIT PËR LICENSË

Subjekti (emri), me NUIS:dhe me përfaqësues ligjor Z./Znj ka aplikuar pranë ZMR me datë për licensë/amendim/ ose rinovimin licensës për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.. Subjekti ndodhet në Rrugën Nr.,.....QytetiTel fax email .

Pajisjet/burimet radioaktive

Disponon aparaturën me rreze X/ ose burimin radioaktiv..... me të dhënat e mëposhtme:

Subjekti në aplikimin e tij ka plotësuar kriteret e aplikimit të licensës, mbështetur në rregulloren Nr.10 datë 07.01.2010 mbi "Licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues" sidhe rregulloreve të tjera përkatëse .

Aplikimi

Subjekti ka plotësuar kriteret sipa pikave në aplikimet përkatëse

Të pasqyrohet në mënyrë narrative i gjithë dokumentacioni i plotësuar nga subjekti për cdo pikë në aplikim.

Konkluzione

Duke u bazuar në dokumentacionin e dërguar pranë ZMR-së veprimtaria e subjektit me burime/gjeneratorë të rrezatimit jonizues është në përputhje me rregulloret në fuqi si dhe rubrikat e aplikimit për licensë janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Inspektor

Tiranë,

SEKRETARI

Rustem PACI

KRYETARI

Ogerta MANASTIRLIU